



BiEPAG

*Dhjetor 2023*

**Tranzicioni i  
energjisë në Kosovë:**

**MES PRIVATIZIMIT  
DHE LIBERALIZIMIT  
TË TREGUT**

*Autorë: Donika Emini dhe Zoran Nechev  
Me kontribut nga Gresa Hasa, Qendra për Studime mbi  
Evropën Juglindore, Universiteti i Gracit, Austri*

---



---

# Hyrje

---

Ky dokument politikash trajton sektorin energjetik të Kosovës gjatë një momenti kritik të tranzicionit të tij drejt qëndrueshmërisë. Dokumenti thellohet në faktorët gjeopolitikë që ndikojnë në këtë transformim energjetik, duke hedhur dritë mbi perceptimet e publikut për partnerët energjetikë të Kosovës dhe strategjinë e qeverisë për kalimin të burimit të rinovueshëm. Për më tepër, dokumenti shqyrton krizën energjetike të shkaktuar nga agresioni rus ndaj Ukrainës, gjë që rriti edhe më tej kërkesën për qëndrueshmëri dhe tranzicion brenda në Kosovë. Konsideratat gjeopolitike dhe kostot thelbësore që lidhen me ngritjen e infrastrukturës së gazit kanë penguar analizimin e gazit si një burim i qëndrueshëm alternativ energjie. Pavarësisht këtyre sfidave, qeveria e Kosovës ka afirmuar përkushtimin e saj për të vazhduar më tej drejt tranzicionit energjetik duke eksploruar energjinë e erës dhe diellit.

Në dokument theksohen sfidat e identifikuara, përfshirë këtu varësinë e konsiderueshme të qymyri dhe nevojën për diversifikimin e energjisë. Përveç kësaj, faza e hershme e zhvillimit të infrastrukturës së energjisë së rinovueshme në Kosovë has në pengesa të tjera. Bashkëjetesa me një monopol publik në prodhimin e energjisë dhe një konsorciumi privat turk që menaxhon shpërndarjen dhe furnizimin e ndërlikon procesin e tranzicionit. Në këtë këndvështrim, ky dokument analizon rolin e Turqisë në procesin e privatizimit të vitit 2012 si dhe sfidat që mund të paraqesë ajo për tranzicionin e ardhshëm të sektorit drejt energjisë së rinovueshme teksa vendi po ecën gradualisht drejt liberalizimit të tregut. Së fundmi, dokumenti e konsideron liberalizimin e tregut si një domosdoshmëri strategjike për të futur konkurrencën dhe rëndësinë e eliminimit të strukturave monopoliste brenda sektorit të energjisë për të lehtësuar një tranzicion më të butë drejt energjisë së rinovueshme.

# Rekomandime

---

BE dhe SHBA duhet të vazhdojnë të mbrojnë nisjen e menjëhershme të privatizimit dhe liberalizimit të tregut në sektorin energjetik të Kosovës për të rritur efikasitetin ekonomik dhe për të nxitur konkurrencën.

BE dhe SHBA duhet të kenë si prioritet investimet strategjike në modernizimin e termocentraleve me qymyr të Kosovës si një zgjidhje e përkohshme gjatë tranzicionit të vazhdueshëm të energjisë.

BE dhe SHBA duhet të vazhdojnë të mobilizojnë mbështetje të konsiderueshme financiare dhe të ofrojnë ekspertizë për të lehtësuar tranzicionin e energjisë në Kosovë.

BE dhe SHBA duhet të zgjerojnë ndihmën financiare për nismat në vazhdim, veçanërisht në sektorin e banimit, për të avancuar programet e efikasitetit të energjisë dhe për t'u harmonizuar me përpjekjet e qeverisë.

---

---

# Harta e infrastrukturës së 'shpërbërë' të energjisë në Kosovë

---

Tregu i energjisë në Kosovë është ende duke u rimarrë veten nga lufta e vitit 1999, veçanërisht në aspektin e tij organizativ, teknik dhe tregtar, teksa përpiqet të modernizojë infrastrukturën e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, infrastrukturë që u krijua gjatë periudhës së Jugosllavisë. Si pjesë e këtij transformimi, sistemi elektroenergjetik i Kosovës po kalon nga një strukturë e integruar vertikalisht në një mjedis më të orientuar drejt tregut.

Gjatë administratës së UNMIK' në fillim të viteve 2000, ndërkohë që institucionet e Kosovës ishin ende të përkohshme, qëllimi ishte të ndryshohej sektori i energjisë duke shpërbërë Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), duke krijuar kështu ente të pavarura për secilin shërbim të ofruar. Struktura e KEK-ut ishte e integruar vertikalisht dhe e projektuar për të menaxhuar të gjithë ciklin energjetik, duke e bërë atë një nga korporatat më të mëdha në Kosovë. Në procesin e shpërbërjes së KEK-ut, në vitin 2005, autoritetet e Kosovës krijuan Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT), një ndërmarrje publike dhe anëtare e Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ENTSO-E). KOSTT është përgjegjës për menaxhimin e transmetimit dhe aspekteve të tjera operative të sistemit të energjisë elektrike. Po ashtu, Shërbimi i Shpërndarjes i Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) është një kompani në pronësi të një konsorciumi turk, i përbërë nga Çalik Holding dhe Limak. KEDS filloi të funksionojë në vitin 2013, duke kontrolluar rrjetin dhe infrastrukturën e shpërndarjes së energjisë, ndërsa Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike (KESCO) mbikëqyr faturimin. Kjo kompani u krijua në vitin 2015.

Zinxhiri i furnizimit me energji elektrike në Kosovë karakterizohet nga një ndërthurje e ndërmarrjeve shtetërore dhe subjekteve private. Për sa i përket prodhimit të energjisë, KEK-ut i është rezervuar një pozicion kyç në infrastrukturën energjetike. KEK-u prodhon energji elektrike kryesisht përmes dy termocentraleve kryesore me bazë qymyri, Kosova A dhe Kosova

B, dhe është përgjegjës për minierat e qymyrit (linjitet) që i furnizojnë këto termocentrale. Të dy termocentralet u ndërtuan në kohën e Jugosllavisë dhe tani tejkalojnë jetëgjatësinë e rekomanduar operative. Ibër-Lepenci operon dhe mbikëqyr hidrocentralin e Ujmanit, i cili mbështetet në rezervuarë për operimin e tij. Kosova ka dy kompani private të prodhimit të energjisë së erës: "Kitka Wind Farm" një kompani me drejtues nga Turqia dhe "Bajgora Wind Farm", një konsorcium gjermano-kosovar.

## Qymyri dhe ndotja, oferta dhe kërkesa për energji

Me një pasuri prej rreth 12.5 miliardë tonë linjit në rezerva gjeologjike, Kosova është e dyta në Evropë dhe e pesta në botë për rezervat më të mëdha të linjitet. Qymyri është burimi i parë për prodhimin e energjisë në Kosovë, me dy termocentrale të vjetra linjiti që prodhojnë deri në 880 MW, në varësi të gjendjes së tyre. Energjia e prodhuar nga qymyri në Kosovë është relativisht e lirë, por vjen me çmim më të lartë mjedisor. Prishtina shpesh herë kryeson listën e qyteteve më të ndotura në botë.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ndërmori hapa kundër Kosovës për "mosrealizim të Planit Kombëtar për Reduktimin e Emetimeve (NERP) dhe për dështim në reduktimin e ndjeshëm të ndotjes së ajrit nga termocentralet."

Në vitin 2004, qeveria e Kosovës u zotua të mbyllë Kosovën A për t'u përafuar me standardet e BE-së për emetimet e gazit. Plani ishte zëvendësimi i tij me një termocentral të ri që kërkonte një miliard euro investim. Termocentrali i ri Kosova C/Kosova e Re ishte planifikuar të vihej në zbatim në bashkëpunim me një partner të fuqishëm financiar, siç është Banka Botërore, në vitin 2017.

Vendimi për të ndërtuar termocentralin Kosova e Re shkaktoi reagime të shumta nga organizatat e shoqërisë civile, reagime që lidheshin kryesisht me

**Në vitin 2022, kërkesa për import u rrit pasi një pjesë e Kosovës A, blloku A5, u shemb. Duke qenë çdo ditë jashtë funksionit KEK-ut i ka kushtuar së paku 1 milion euro. KEK-u për mosfunksionimin e këtij blloku ka paguar 266 milionë euro, duke shtuar 3.5 milionë për ofertën e dhënë për riparimin e tij. Pra, brenda më pak se një viti, KEK-u ka paguar 299.5 milionë euro për të mbuluar humbjet e shkaktuara nga shembja e bllokut A5.**

shqetësimet mjedisore. Gjithsesi, oferta për investim u miratua. Më pas erdhën sfida të shumta. Ofertën e fitoi kompania me qendër në Mbretërinë e Bashkuar, ContourGlobal, por shumë detaje në lidhje me kontratën nuk u bënë publike. Projekti pati disa vite ngërçi, ku vihej re pak ose aspak progres deri në vitin 2020, kur ContourGlobal, kompania që më parë kishte nënshkruar një marrëveshje me qeverinë e Kosovës, u tërhoq nga projekti. Megjithatë, kjo ngjarje solli momentin e duhur për të mbyllur kapitullin e përpjekjeve për ndërtimin e termocentraleve të reja energjetike me djegie qymyri në Kosovë.

Kriza energjetike e vitit 2023 nxori dukshëm në pah nevojën urgjente për gjenerim të qëndrueshëm, me ngarkesë bazë të energjisë elektrike brenda Kosovës për të plotësuar boshllëkun energjetik.<sup>1</sup> Kosova prezantoi planin për zhvillimin e energjisë së rinovueshme, por ndërkohë pranoi nevojën e ngutshme për të rinovuar dy termocentralet ekzistuese si një hap i përkohshëm.

## Privatizimi i Shpërndarjes së Energjisë dhe Perceptimet e Qytetarëve

Kosova e miratoi strategjinë e parë energjetike në vitin 2007. Në këtë strategji shqyrtoheshin kryesisht vetëm problemet e vazhdueshme brenda KEK-ut, siç janë rrjeti i prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë dhe faturimi i energjisë. Në vitin 2008, qeveria nisi procesin e privatizimit. Ky proces privatizimi përfundoi në vitin 2013 kur kontrollin e KEDS-it e mori konsorciumi turk Limak-Çalık.<sup>2</sup>


Kur analizojmë perceptimin e publikut për privatizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë në Kosovë, është me rëndësi të madhe të bëjmë dallimin mes privatizimit dhe fazës pas privatizimit të shpërndarjes së energjisë. Nga njëra anë, procesi i privatizimit ka qenë objekt i debatit të vazhdueshëm, në radhë të parë lidhur me çmimin shumë të ulët të rrjetit të shpërndarjes dhe pretendimet

1 Taylor, A. (2022) 'Kriza energjetike e Kosovës merr një tjetër goditje pasi termocentrali pëson probleme teknike', [www.euractiv.com](https://www.euractiv.com/section/politics/news/kosovos-energy-crisis-takes-another-hit-as-power-plant-suffers-technical-problems/), [online] Gjetet në adresën: <https://www.euractiv.com/section/politics/news/kosovos-energy-crisis-takes-another-hit-as-power-plant-suffers-technical-problems/> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

2 Ekonomia, M. of E. (2012) 'Nënshkruhet kontrata për privatizimin e distribucionit të KEK', Ekonomia, [online] Gjetet në adresën: <https://www.ekonomia.info/sq/energjetike/nenshkruhet-kontrata-per-privatizimin-e-distribucionit-te-kek> (Aksesuar më 15 tetor 2023).

për lidhje të elitës politike me Turqinë, të cilat përcaktuan procesin.<sup>3</sup> Në anën tjetër, në periudhën pas privatizimit janë vënë re përmirësime në shpërndarjen e energjisë, që ishte një problem i vazhdueshëm pas luftës në Kosovë. Ky përmirësim, të paktën nga këndvështrimi i qytetarëve, karakterizohet nga reduktimi i ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike. Kësisoj, ai krijoi perceptimin te publiku se privatizimi ka rritur sigurinë energjetike në Kosovë. Ndaj, ai krijoi artificialisht perceptimin e sigurisë energjetike tek qytetarët siç tregohet në Figurën 1.<sup>4</sup>

**Figura 1.** Qëndrimet ndaj privatizimit të shpërndarjes dhe furnizimit me energji. Burimi: Sondazhi i BiEPAG, N = 1,000 [2023]



**Privatizimi i shpërndarjes së energjisë me një çmim të mjaft të leverdishëm prej 26 milionë eurosh:** Privatizimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë me një vlerë të reduktuar ndjeshëm në krahasim me vlerën e aseteve të saj ngriti shqetësime për shkak të mungesës së transparencës në procesin e prokurimit. Këto shqetësime u intensifikuan kur i njëjti pronar i bleu të dy divizionet e KEK-ut që është përgjegjës për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë.<sup>5</sup>

3 Olluri, P. (2018) 'Kryeministri i Kosovës vendos aleatin në krye të organit të privatizimit', *Balkan Insight*, [online] Gjendet në adresën: <https://balkaninsight.com/2012/11/22/kosovo-pm-installs-ally-to-head-privatisation-body/> (Aksesuar më 28 tetor 2023); Morina, D. (2018) 'Thaçi konsolidon aleancën e Kosovës me Turqinë', *Balkan Insight*, [online] Gjendet në adresën: <https://balkaninsight.com/2016/12/30/thaci-in-turkey-12-30-2016/> (Aksesuar më 28 tetor 2023).

4 Intervistë me ekspertin 4, (14 korrik 2023).

5 Hashani, A., Lumir, A., Vokri, V. Dhe Pozhegu, D. (2016) 'Privatizimi në sektorin e energjisë, KFOS dhe RIIVEST, Fondacioni për Shoqërinë e Hapur (KFOS) dhe Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest, [online] Gjendet në adresën: [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/21/Privatizimi\\_Sektorin\\_energji\\_shq1474445380.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/21/Privatizimi_Sektorin_energji_shq1474445380.pdf) (Aksesuar më 14 tetor 2023).



**Monopoli i tregut:** Objektivi fillestar i privatizimit të sistemit të shpërndarjes kishte për qëllim eliminimin e joefikasitetit dhe mungesës së përfitimit të lidhur me kompanitë tradicionale të energjisë të integruara vertikalisht. Sektori i energjisë në Kosovë, ndërkohë që po i nënshtrohej privatizimit, i duhet ende të kalojë në një strukturë të liberalizuar; ai vazhdon të funksionojë nën një kuadër të ri monopoli.<sup>6</sup> Zbatimi i modelit liberal ka hasur në pengesa rregullatore dhe konflikte interesi. Disa linja elektrike janë në pronësi të KEDS-it, nën të njëjtin grup pronësor si KESCO, duke krijuar shqetësime të mëdha për konflikt interesi.<sup>7</sup> Kjo situatë ka penguar krijimin e një tregu konkurrues.<sup>8</sup> Për më tepër, parashikohet që një situatë e tillë të pengojë edhe më shumë tregun kur të ndodhë tranzicioni i energjisë dhe tregu i energjisë të shkojë drejt liberalizimit të plotë.<sup>9</sup>

**Fitimi me blerjen e energjisë elektrike nga KEK-u:** Sipas kësaj strukture, KEDS-i e blen energjinë elektrike me çmim fiks, duke i bërë të mundur atij të nxjerrë fitime kur kemi rritje të çmimeve. Megjithatë, në kohë krize, KEDS-it i është dashur të kërkojë subvencione apo ndihmë nga qeveria.<sup>10</sup> Si rezultat, edhe pse KEDS-i nuk e prodhon energjinë e tij por e blen atë nga KEK brenda një tregu të rregulluar, ai vazhdon të funksionojë sikur të ishte një kompani e integruar vertikalisht.<sup>11</sup>

**Rritje e cilësisë dhe besueshmërisë:** Humbjet teknike dhe komerciale pas privatizimit shkaktuan një humbje vjetore prej më shumë se 40 për qind të energjisë elektrike. Privatizimi ndihmoi në uljen e ndjeshme të këtyre humbjeve përmes rritjes së investimeve në infrastrukturën e energjisë elektrike.<sup>12</sup>

6 Vitia, D. (2020) 'Tregu energjetik i Kosovës: Kur do të përfundojë monopoli?', Prishtina Insight, [online] Gjendet në adresën: <https://prishtinainsight.com/kosovas-energy-market-when-will-the-monopoly-end-mag/> (Aksesuar më 28 tetor 2023).

7 Intervistë me ekspertin e energjisë dhe pronarin e burimeve të rinovueshme të energjisë (11 korrik 2023).

8 Vitia, D. (2020b) 'Privatizimi i keds-it pamundëson liberalizimin real të Tregut të energjisë', Raporto Korrupsionin! KALLXO.com, [online] Gjendet në adresën: <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/privatizimi-i-keds-it-pamundeson-liberalizimin-real-te-tregut-te-energjiise/> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

9 Vitia, D. (2020) 'Privatizimi i KEDS-it pamundëson liberalizimin real të Tregut të energjisë', kallxo.com, [online] Gjendet në adresën: <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/privatizimi-i-keds-it-pamundeson-liberalizimin-real-te-tregut-te-energjiise/> (Aksesuar më 15 tetor 2023).

10 Intervistë me ekspertin 3 (18 korrik 2023).

11 Intervistë me ekspertin 2, (12 korrik, 2023); Qeveria e Kosovës (2012) 'Privatizimi i Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë - Plani i Zbatimit,' Zyra e Kryeministrit, [online] Gjendet në adresën: [https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/IA\\_notarized\\_opt.pdf](https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/IA_notarized_opt.pdf) (Aksesuar më 28 tetor 2023).

12 Banka Botërore (2017) Privatizimi i KEDS në Kosovë- Banka Botërore, IFC International Finance Cooperation - Anëtar i Grupit të Bankës Botërore, [online] Gjendet në adresën: <https://documents.worldbank.org/curated/en/742311542227814406/pdf/132069-KosovoKEDSPrivatization-Booklet-FINAL.pdf> (Aksesuar më 5 tetor 2023).

# Subvencionimi i energjisë: hap i përkohshëm i ndihmuar nga BE dhe SHBA

Për të zbutur ndikimin e rritjes së çmimeve të energjisë gjatë krizave energjetike të nxitura nga agresioni rus kundër Ukrainës, Qeveria e Kosovës akordoi 120 milionë euro për sektorin e energjisë. Ky subvencion iu kalua konsumatorëve përmes zbritjeve në faturat e energjisë elektrike dhe u përdor për të mbuluar subvencionet e importit. Kjo marrëveshje mbrojti në mënyrë efektive prej rritjes së çmimit bizneset dhe familjet që konsumonin më pak se 800 kWh në muaj. Në këtë drejtim, roli i BE-së dhe SHBA-së në subvencionimin e energjisë është vendimtar. Projekti i Korporatës Sfida e Mijëvjeçarit (MCC) i administruar përmes programit të Fondacionit të Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK) ka ofruar mbështetje të konsiderueshme për familjet dhe ka planifikuar investime në shkallë të gjerë në subvencionet e energjisë.<sup>13</sup> Këtu kemi ndryshim loje, veçanërisht gjatë dimrit kur energjia përdoret në masë të gjerë për ngrohje.<sup>14</sup> BE ka prezantuar një nismë me një fond prej 75 milionë eurosh për të subvencionuar faturat e energjisë, duke mbështetur metodat alternative të ngrohjes dhe inkurajimin e kursimit të energjisë të publiku për të përmirësuar efikasitetin e energjisë për familjet dhe ndërmarrrjet.<sup>15</sup>

Gjatë krizës energjetike, Kosova filloi të zbatonte strategjinë e energjisë të vitit 2023 për të filluar me investimet në prodhimin e qëndrueshëm të energjisë në vend, duke reduktuar varësinë nga importet e kushtueshme dhe duke u larguar nga përdorimi i qymyrit. Strategjia shpalli zyrtarisht çmontimin e një

<sup>13</sup> Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës - Millennium Foundation Kosovo (2022) 'Fjalorth i Fondacionit të Mijëvjeçarit në Kosovë', MFK, [online] Gjetet në adresën: <https://millenniumkosovo.org/wp-content/uploads/2022/12/MFK-BEYOND-BOOK-7DEC2022-DIGITAL-S.pdf> (Aksesuar më 1 nëntor 2023); MCC (2022) 'MCC dhe Kosova festojnë një moment historik në rikuperimin e sektorit energjetik prej 285 milionë dollarësh', Korporata Sfida e Mijëvjeçarit, [online] Gjetet në adresën: <https://www.mcc.gov/news-and-events/release/release-101922-mcc-and-kosovo-celebrate-energy-sector-major-milestone> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

<sup>14</sup> Instituti GAP (2023) 'Përfitimet Ekonomike të Efiçencës së Energjisë në Kosovë', Instituti GAP, [online] Gjetet në adresën: [https://www.institutigap.org/documents/58261\\_eficienca\\_energjiqe\\_EN\\_\(draft3\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/58261_eficienca_energjiqe_EN_(draft3).pdf) (Aksesuar më 31 tetor 2023).

<sup>15</sup> Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë (2023) 'Paketa e mbështetjes energjetike: BE i jep 75 milionë euro Kosovës për ta ndihmuar të përballojë krizën energjetike', EEAS, [online] Gjetet në adresën: [https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/energy-support-package-eu-grants-eur-75-million-kosovo-help-it-cope-energy-crisis\\_en?s=321](https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/energy-support-package-eu-grants-eur-75-million-kosovo-help-it-cope-energy-crisis_en?s=321) (Aksesuar më 16 tetor 2023).

---

# Strategji e re: largimi nga qymyri, duke i thënë jo gazit, eksplorimi i burimeve të rinovueshme

---

termocentrali me qymyr, duke vendosur si objektiv që 35 për qind e energjisë elektrike për konsum deri në vitin 2031 të vijë nga burime të rinovueshme dhe duke rritur integrimin në tregjet rajonale të energjisë.<sup>16</sup> Nga ana tjetër, strategjia përfshin edhe plane për bateri me kapacitet ruajtje të energjisë prej 390 MWh, të financuara përmes një granti nga Korporata Sfida e Mijëvjeçarit, për të mbështetur energjinë e rinovueshme dhe qëndrueshmërinë e rrjetit.

Kosova synon të reduktojë konsumin e energjisë me 32.5 për qind deri në vitin 2030 krahasuar me nivelet e parashikuara, në përputhje me objektivat e BE-së për eficiency e energjisë. Strategjia parashikon zhvillimin e energjisë së erës dhe diellit, ku kjo e fundit e bën Kosovën të vetmin vend në rajon që eksploron këtë formë të prodhimit të energjisë.<sup>17</sup>

Ambicia për energji të rinovueshme mbështetet gjerësisht nga qytetarët e Kosovës, e nxitur kryesisht nga nevoja për të trajtuar sfidat e ndotjes së ajrit. Pjesa më e madhe e qytetarëve besojnë se deri në vitin 2050 Kosova duhet të mbështetet tërësisht në burimet e rinovueshme (siç tregohet edhe në Figurën 2).


---

<sup>16</sup> Todorović, I. (2022) 'Energjitë e rinovueshme janë themeli i strategjisë së Kosovës\* për energji deri në vitin 2031', *Balkan Green Energy News*, [online] Gjetet në adresën: <https://balkangreenenergynews.com/renewables-are-cornerstone-of-kosovo-energy-strategy-through-2031/> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

<sup>17</sup> Demiri, L. (2023) 'Energjia diellore në lulëzim', *Kosovë 2.0*, [online] Gjetet në adresën: <https://kosovotwopointzero.com/en/solar-blossoms/> (Aksesuar më 24 tetor 2023).

---

**Figura 2** Qëndrimet ndaj energjisë së rinovueshme. Burimi: Sondazhi i BiEPAG, N = 1,000 [2023]



## E ardhmja: Kosova po tenton energjinë e erës dhe atë diellore

Kosova ka aktualisht dy parqe funksionale për prodhim energjie erë. Me një kapacitet prej 32.4 MW, Impianti i Erës Kitka, që aktualisht është në një zgjerim e sipër, është ndërtuar duke përdorur një kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).<sup>18</sup> Air Energy, një ent i angazhuar i krijuar posaçërisht për këtë nismë, drejton projektin, ndërkohë që pronësia është e një kompanie turke.<sup>19</sup> Po ashtu, Developer Air Energy 2 do të ndërtojë në Kosovë dy impiante të prodhimit të energjisë me erë dhe një impiant për prodhimin e energjisë nga dielli, me një kapacitet të kombinuar prej 99.6 MW.<sup>20</sup> Kjo evidenton

<sup>18</sup> Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (2023) 'Era Kitka, BERZH, [online] Gjetet në adresën: <https://www.ebrd.com/work-with-us/projects/psd/kitka-wind.html> (Aksesuar më 28 tetor 2023). Notus është një kompani gjermane.

<sup>19</sup> Impianti i erës Kitka (2023) KITKA - Air Energy ShPK, [online] Gjetet në adresën: <http://www.kitkawpp.com/EN,2653/group-companies.html> (Aksesuar më 28 tetor 2023).

një prani të konsiderueshme të Turqisë në prodhimin e energjisë për të ardhmen në Kosovë. Pas projektit të suksesshëm në Kitka, Kosova filloi ndërtimin e impiantit me erë të Bajgorës, i cili është vënë në punë kohët e fundit. Ky park me erë, më i madhi në Kosovë me një kapacitet prej 102.6 MW, është ndërtuar nga Notus Energy<sup>21</sup> duke përdorur një kredi nga BERZH<sup>22</sup>, me pjesëmarrjen e Erste Bank dhe NLB Group.<sup>23</sup> Ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, ishte e pranishme në përrurimin e impiantit, duke treguar kështu mbështetjen për synimin e Kosovës për të kaluar në prodhimin dhe përdorimin e energjisë të rinovueshme.<sup>24</sup> Nga ana tjetër, Impianti i Erës i Budakovës (46 MW) është në tubacion dhe ofron kapacitet të konsiderueshëm gjenerues.<sup>25</sup>

Përveç energjisë së prodhuar nga era, Kosova synon të arrijë objektivin prej 600 MW energji diellore dhe është zotuar të ndërtojë një fermë diellore 150 MW. Grupi i Energjisë Diellore në Evropë (SEGE) ka nisur ndërtimin e fermave diellore, të cilat do të funksionojnë pa subvencione nga qeveria dhe ku i gjithë prodhimi i tij do të shitet në tregun e lirë.<sup>26</sup>

Në maj të vitit 2023, Kosova hapi një procedurë konkurruese tenderimi për të siguruar një marrëveshje 15-vjeçare të blerjes së energjisë elektrike për projektet fotovoltaike. Kjo procedurë shënon ankandin e parë të energjisë diellore në rajon, me një kapacitet të disponueshëm që varion nga 90 MW në 105 MË.<sup>27</sup> Afati fillestar është shtyrë dy herë, ku më i fundit raportohet se ka skaduar më 16 tetor. Mbi 140 kompani, përfshirë ato nga Evropa Juglindore, kanë treguar interes të madh për të marrë pjesë në ankandin e energjisë diellore.<sup>28</sup>

20 Balkan Green Energy News (2021b) 'Holding Guris i Turqisë do të ndërtojë ferma me erë në Kosovë\* dhe Ukrainë', Balkan Green Energy News, [online] Gjendet në adresën: <https://balkangreenenergynews.com/turkeys-guris-holding-build-windfarms-kosovo-ukraine/> (Aksesuar më 28 tetor 2023).

21 NOTUS Energy (2021) 'Ferma me erë 102.6 MW në Kosovë fillon të ushqejë rrjetin - investimi më i madh direkt që nga shpallja e pavarësisë së vendit', NOTUS energy, [online] Gjendet në adresën: <https://www.notus.de/en/news/1026-mw-windfarm-kosovo-begins-feeding-grid-largest-direct-investment-countrys-founding> (Aksesuar më 28 tetor 2023).

22 Bennett, V. (2019) '18 milionë euro hua nga BERZH për fermën e parë me erë të Kosovës', Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), [online] Gjendet në adresën: <https://www.ebrd.com/news/2019/18m-ebrd-loan-to-kosovos-first-wind-farm.html> (Aksesuar më 28 tetor 2023); Reuters (2019) BERZH do të japë 58 milionë euro hua për të ndërtuar parkun më të madh të erës në Kosovë, [online] Gjendet në adresën: <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-energy-wind-idUSKBN1YK1EC> (Aksesuar më 28 tetor 2023).

23 Balkan Green Energy News (2021) 'Ferma e erës e Kosovës 102.6 MW Bajgora futet në linjë', Balkan Green Energy News, [online] Gjendet në adresën: <https://balkangreenenergynews.com/kosovos-102-6-mw-wind-farm-bajgora-goes-on-stream/> (Aksesuar më 28 tetor 2023).

24 Buxhovi, A. (2022) 'Inaugurohet parku i erës në Mitrovicë, investim qindra milionësh nga Gjermania', GazetaBlic, [online] Gjendet në adresën: <https://gazetablic.com/inagurohet-parku-ieres-ne-mitrovice-investim-qindra-milionesh-nga-gjermania/> (Aksesuar më 24 tetor 2023).

25 Isufi, A. (2022) 'Parku i Ri i Erës u përshëndet si një hap drejt energjisë së gjelbër', Prishtina Insight, [online] Gjendet në adresën: <https://prishtinainsight.com/new-wind-park-hailed-as-step-towards-green-energy/> (Aksesuar më 31 tetor 2023).


26 Reuters (2023) Konsorciumi fillon ndërtimin e fermës diellore 150 MW në Kosovë, [online] Gjendet në adresën: <https://www.reuters.com/business/energy/consortium-starts-building-150-mw-solar-farm-kosovo-2023-05-19/> (Aksesuar më 1 nëntor 2023). Impiantin po e ndërton grupi gjerman i pajisjeve dhe shërbimeve të energjisë Siemens Energy AG.

27 Todorović, I. (2023a) 'Kosova\* hap ankandin për energjinë diellore deri në 105 MW', Balkan Green Energy News, [online] Gjendet në adresën: <https://balkangreenenergynews.com/kosovo-initiates-solar-power-auction-for-up-to-105-mw/> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

Edhe pse pjesa më e madhe e qytetarëve besojnë se Kosova duhet të mbështetet të SHBA (siç tregohet në Figurën 3) për sa i përket energjisë, Qeveria e Kosovës nuk tregoi interes për të ndjekur gazsjellësin që lidh Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut.<sup>29</sup> Kështu, granti prej 234 milionë dollarësh nga agjencia amerikane MCC është dhënë për të mbështetur ambicien e Kosovës për energjinë e rinovueshme diellore.<sup>30</sup> Projekti kushtëzohet nga rritja e kapaciteteve të Kosovës në energjinë e rinovueshme, përkatësisht në energjinë diellore. Ai përfshin blerjen dhe instalimin e baterive me kapacitet të lartë, me një kapacitet të kombinuar të instaluar prej 200 megavat-orë (MWh).<sup>31</sup> Projekti është tërësisht në pronësi lokale, dhe Kosova po përzgjedh ekipin dhe po përgatitet për të nisur me zbatimin e projektit. Kjo është reflektuar në perceptimin ndaj BE-së dhe SHBA-së, të cilat shihen si mbështetësit më të mëdhenj të tranzicionit energjetik në Kosovë (siç tregohet në Figurën 4).

**Figura 3:** Qëndrimet ndaj varësisë të partnerët e energjisë.

Burimi: Sondazhi i BiEPAG, N = 1,000 [2023]




28 Todorović, I. (2023) 'Ankandi i energjisë diellore në Kosovë\* tërheq interesin e mbi 140 kompanive', Balkan Green Energy News, [online] Gjendet në adresën: <https://balkangreenenergynews.com/solar-power-auction-in-kosovo-draws-interest-from-over-140-companies/> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

29 Bami, X. (2022) 'Refuzimi i gazit, Kosova hedh sytë nga fondet e ShBA-ve për energjinë e rinovueshme, Balkan Insight, [online] Gjendet në adresën: <https://balkaninsight.com/2022/05/30/rejecting-gas-kosovo-eyes-us-funds-for-renewable-energy/> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

30 MCC (2022a) 'Bordi i MCC miraton grantin \$202 milionë dollarë për përmirësimin e sektorit të energjisë në Kosovë', Korporata Sfida e Mijëvjeçarit, [online] Gjendet në adresën: <https://www.mcc.gov/news-and-events/release/release-070122-mcc-board-approves-kosovo-compact> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

31 Spasić, V. (2022) 'Kosova\* do të instalojë sistemin e baterisë 200 MWh për ruajtje të energjisë', Balkan Green Energy News, [online] Gjendet në adresën: <https://balkangreenenergynews.com/kosovo-to-install-200-mwh-battery-storage-system/> (Aksesuar më 1 nëntor 2023).

**Figura 4:** Qëndrimet ndaj partnerëve në tranzicionin e energjisë.  
Burimi: Sondazhi i BiEPAG, N = 1,000 [2023]



## Rruga për të ardhmen dhe rekomandime

Pengesa kryesore në tranzicionin energjetik të Kosovës është varësia e saj e madhe te qymyri, mungesa e diversifikimit të energjisë dhe nevoja për interkoneksione të mjaftueshme.

Ndonëse prodhimi i energjisë në Kosovë ka mbetur në pronësi publike, shpërndarja dhe furnizimi i energjisë i janë nënshtruar privatizimit rreth një dekadë më parë dhe aktualisht kontrollohen nga konsorciumi turk Limak-Çalik.

**Synimi për tranzicionin e energjisë:** Kosova është zotuar të largohet gradualisht nga përdorimi i qymyrit për t'i dhënë përparësi përdorimit të energjisë së erës dhe asaj diellore. Është për t'u theksuar se motivimi për këtë ndryshim vjen nga vetë brenda Kosovës. Gjithsesi, BE dhe SHBA duhet të japin mbështetjen e tyre për të ndihmuar në kapërcimin e sfidave të mëdha në rrugën drejt transformimit të energjisë.

**Privatizimi dhe liberalizimi i tregut:** Futja e konkurrencës në treg është thelbësore për arritjen e efikasitetit ekonomik në procesin e liberalizimit. Lëvizja drejt burimeve të rinovueshme u hap tregun e energjisë kompanive private në Kosovë dhe nxit konkurrencën. Hapi drejt burimeve të rinovueshme duhet të ecë paralelisht me liberalizimin e tregut.

**Tranzicioni nga qymyri te burimet e rinovueshme:** Vendimi për të hequr dorë nga gazi si një zgjidhje e përkohshme ka zgjatur varësinë e Kosovës te djegia e qymyrit për prodhimin e energjisë. Prandaj, rekomandohet që Kosova të ketë si përparësi investimet në përmirësimin e termocentraleve të saj me qymyr si masë e përkohshme gjatë tranzicionit të vazhdueshëm të energjisë. Këto investime janë me rëndësi të madhe për garantimin e sigurisë energjetike dhe trajtimin e problemeve mjedisore, veçanërisht nevojën për të reduktuar ndotjen e ajrit.

**Orientim dhe mbështetje financiare për të përfunduar tranzicionin e energjisë:** Për të nxitur me sukses tranzicionin energjetik të Kosovës, BE dhe SHBA duhet të ofrojnë stimuj të konsiderueshëm financiarë dhe ekspertizë për të përballuar krizën e vazhdueshme energjetike dhe për të ulur ndotjen e ajrit. Kjo mbështetje është me rëndësi të madhe për suksesin e nismës, duke theksuar më shumë nevojën për asistencë në përmbushjen me sukses të tranzicionit të energjisë. Përveç kësaj, BE duhet të rrisë mbështetjen financiare për nismat e vazhdueshme të Kosovës, veçanërisht në sektorin e banimit, duke vazhduar më tej me programet e eficientës së energjisë. Rritja e përfshirjes aktuale të bashkëfinancimit është jashtëzakonisht e rëndësishme për zbatimin efektiv të masave të eficientës së energjisë dhe për mbështetjen e përpjekjeve të qeverisë.



---

# Rreth neth

---

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the Balkans - EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave. Ky grup përbëhet nga studiues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber (Kordinator), Bojan Baća, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Nikola Dimitrov, Vedran Džihic, Richard Grieveson, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić (Asistent kordinator), Srđan Majstorović, Jovana Marović, Zoran Nechev, Damir Kapidžić, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergji Vurmo, Natasha Wunsch.

**<https://biepag.eu>**

Kontakt: [info@biepag.eu](mailto:info@biepag.eu)

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha gjithëpërfshirëse - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritit në BE. Fondacioni mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platforma ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

**[www.balkanfund.org](http://www.balkanfund.org)**

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive,  
[aleksandra.tomanic@balkanfund.org](mailto:aleksandra.tomanic@balkanfund.org)

---

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe arsimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar. Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon rregullisht konferenca dhe seminare ndërkombëtare për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore.

**<http://csees.uni-graz.at/>**

*Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER,*

*Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore,*

*[florian.bieber@uni-graz.at](mailto:florian.bieber@uni-graz.at)*

*Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Evropian për Klimën. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim është e autorit(ve). Fondacioni Evropian i Klimës nuk mund të jetë përgjegjës për përdorimet që mund t'i bëhen informacioneve që jepen ose shprehen në këtë studim.*

*Fondi Evropian për Ballkanin 2023. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.*



